

Data 14/10/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “ Rikonstruksion i objektit Qendra e Personel Rekrutimit , Godina nr.35 ”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45210000-2, Punime ndërtimi.

Vlera e fondit limit: 110,862,369.95 (Njëqindë e dhjet milion e tetëqindë e gjashtedhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë nëntedhjetë e pesë) lek pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 6 (gjashtë) muaj kalendarikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike, Projekti etj. dhe llogaritja e Fondit Limit përcillen nga Autoriteti Kontraktor i cili kërkon realizimin e punimeve.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **55,431,184** (pesëdhjetë e pesë milion e kateqind e tridhjetë e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e kater) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **221,724,738** (dyqind e njezet e një milion e shtateqind e njezet e kater mijë e shtateqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- 1.3** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.4** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllorë të kontratës që prokurohet konkretisht: **55,431,184** (pesëdhjetë e pesë milion e kateqind e tridhjetë e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e kater) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **221,724,738** (dyqind e njezet e një milion e shtateqind e njezet e kater mijë e shtateqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme. Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e

tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: **”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: **“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”**

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin

kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

2.3.2 Licënsa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP-3C** Rikonstrukcion dhe mirmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-2A** Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.
- **N.S-4 B** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- **NS-12 A** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- **NS-14 A** Impiante të brendshme elektrike , telefonike , radiotelefoni TV.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-3C	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasada.	<p>F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F V konstruksione metalike te perbera F V konstruksione metalike te thjeshta Plinta b/a C20/25 Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25 Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m Brez b/a C20/25 Plinta b/a C20/25 Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25 Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15 Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa kunder lageshtires etj F V dritare d/alumini plastike me dopio xham V F dyer te brendeshme tamburate te rimesuara F V dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. F V dyer te brendeshme metalike te blinduara. Dyer te blinduara Dyer d/alumini tek xh. Heqje vetrare duralumini ekzistuese Heqje parmake metalike, shkalleh e ballkonesh (Me zmeriletrice) Shtresë termoizoluese me polisterol 5cm + ne parapetin e taraces H/izolim me 2 l ruberoid d=4mm e sipërmja e granular + ne parapetin e taraces Pileta shkarkimi në taracë 100x100 mm Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Suvatim me llaç-çimento Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartesi Suvatim me grafiato h > 4 m Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm Patinim muri allçi Patinim tavani allçi Veshje fasade me pllake terakote Shtrese pllaka mermeri 3 cm Shkalle mermer montazhi Shtrese granili i imet Heqje bordura trotuari ekzistues Shtresë çakëlli F.V. pusete shkarkimi 50x50, h=150, me kapak me zgare gize Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm Kasete shkarkimi me llamarine xingat Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 Veshje kornize llamarine xingat Mbulim çatie me panele sanduich Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama etj.</p>	C (51-100 milionë lekë)

NS-2A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.	<p>F.V tub xingato dhe rakorderi > 1 "</p> <p>F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm</p> <p>FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16</p> <p>Hapje vrimash ne solete deri ne Ø 200 mm</p> <p>Hapje vrimash ne mur deri ne Ø 200 mm</p> <p>F.V tub xingato dhe rakorderi ~ 1 "</p> <p>Termoizolim tubi Ø 1" me armofleks (d35x9)</p> <p>F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm</p> <p>F.V saracineska bronzi Ø 2 " = 50 mm</p> <p>F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm</p> <p>F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm</p> <p>FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16</p> <p>FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16</p> <p>FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16</p> <p>Hapje vrimash ne solete deri ne Ø 200 mm</p> <p>Hapje vrimash ne mur deri ne Ø 200 mm</p> <p>F.V WC allafrenga</p> <p>F.V lavaman porcelani</p> <p>F.V lavapjate llamarine</p> <p>F V bolier 80 liter, uje te ngrohte</p> <p>F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm</p> <p>F.V saracineska bronzi Ø 1 1/4 " = 32 mm</p> <p>F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm</p> <p>FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25</p> <p>Termoizolim tubi Ø 1/2" me armofleks (d22x9)</p> <p>FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25</p> <p>Termoizolim tubi Ø 3/4" me armofleks (d28x9)</p> <p>FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16</p> <p>Termoizolim tubi Ø 1" me armofleks (d35x9)</p> <p>FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=40mm, t = 4.5 mm, Pn 20</p> <p>F.V pilete dysHEMEJE Ø 50</p> <p>Heqje lavaman</p> <p>F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm</p> <p>Hidrant zjarrfikës i brendshëm me kasete, DN40, me vendosje brenda murit</p> <p>Hidrant i jashtëm mbitoke DN70, lidhje me flanaxhe DN 80, PN16 dhe kapje DN 70 UNI 14339</p> <p>Hidrant i jashtëm nentoke, DN70, lidhje me flanaxhe DN80 dhe kapje DN70, UNI 14339</p> <p>F. V Kasete ne sherbim te hidranteve te jashtem, UNI 10779</p> <p>F V Galexhant mekanik 1 1/4 " ; PN16</p> <p>F V Galexhant elektrik</p> <p>Pusete 100x100 cm H=100 cm kapak betoni</p> <p>Termoiz. tub çeliku me armoflex δ=13mm 1 1/2"-2"</p> <p>Termoiz. tub çeliku me armoflex δ=19mm 2 1/2"</p> <p>Termoiz. tub çeliku me armoflex δ=33mm 3"-3 1/2"</p> <p>F V Valvola ajernxjerrese 1 1/4"</p> <p>F V Valvol ballancuese 1 1/2" PN16</p> <p>F V Valvol ballancuese 1 1/4" PN16</p> <p>F V Bashkuese elastike DN80 PN16</p> <p>F V Filter uji vetpastrues (mekanik) për grimca 60÷100 µ ; lidhjet hidraulike 1"</p> <p>F V Reduktor presioni 3/4" PN25</p> <p>F V Nderpreres linje 1 1/4" PN25</p> <p>F V Valvol moskthimi 3/4" PN16</p> <p>F V Termostat ambienti Etj.</p>	A (0-20 milionë lekë)
NS-4B	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me		B (21-50 milionë lekë)

	<p>materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.</p>	<p>Shtresë dyshemeje me pllaka gres porcelanoz 60x60cm + plintusat (100% koridoret dhe WC dhe 10% në ambientet e tjera) Shtresë betoni dekorativ për trotuarin Suvatim fasade me mbrojtje termike me sistem kapotë me 10cm polisterol (tre faqet anësore të fasadës + pjesa e brendshme e fasadës ballore) Tavan i varur me kartonxhes Tavan i varur me gips kundër lagështisë F.V. Dritare kontrolli me knauf 50x50 në tavanet e varura Veshje muri në WC me pllaka gres porcelanoz 60x60, h=2.4m Veshje muri me lesh guri kundër zjarrit (ndarja midis dy kartotekave) Veshje muresh me knauf rezistent ndaj zjarrit (ndarja midis dy kartotekave) F.V. vetratë me profil plastik me dopjo xham F.V. derë e blinduar metalike, antizjarr me veshje llamarine me dorezë antipanik Lyerje fasade me bojë akrelik cil.I-rë Prishje suvatim i jashtëm me grafiato (faqja ballore dhe kollonat 50%) Boje hidroplastike Boje vaji siperfaqe metalik Parapet shkalle e ballkone hekur Ø e korimano druri Boje vaji siperfaqe metalik Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15 Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa kunder lageshtires etj.</p>	
NS-12A	<p>Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit</p>	<p>Montim pompe nxehtesie ajer-uje "Full Inverter" Kapaciteti nominal Nft/ng =189.4/209.3 KW. Montim pompe nxehtesie ajer-uje "Full Inverter" Kapaciteti nominal Nft/ng =153.1/168.8 KW. Montim kondicioner monosplit inverter 24000 BTU njesia e brendeshme tip kasete. Montim njesi e brendeshme tip kasete Nng=2.95-8 KW. Montim njesi e brendeshme tip kasete Nng me te medha se 8 KW. Montim akumulator inercial kapaciteti 1500 lt. Montim akumulator inercial kapaciteti 1000 lt. V.Kondicioner monosplit inverter 24000 BTU njesia e brendeshme tip kasete Njesi e brendeshme tip kasete Nng/ft=2.95/1.44 KW. Montim njesi e brendeshme tip kasete Nng/ft=7.57/3.29 KW. Njesi e brendeshme tip kasete Nng/ft=8.12/3.97 KW. Montim njesi e brendeshme tip kasete Nng/ft=9.5/4.2 KW. Njesi e brendeshme tip kasete Nng/ft=13.7/6.4 KW. Njesi e brendeshme tip kasete Nng/ft=8/6.8 KW. Njesi e brendeshme tip kasete Nng/ft=19/8.9 KW.Specifikimet sipas shen. Teknike Njesi e brendeshme tip kasete Nng/ft=21/9.9 KW. Njesi e jashtme e hyrjes me akses kontrolli, digitale me opSION akses kontrolli me shenje gishti, dhe karte te personalizuar stafi, me dalje data dhe lidhje me panelin e akses kontrollit Njesi e brendshme e hyrjes me akses kontrolli, digitale me opSION akses kontrolli me shenje gishti, dhe karte te personalizuar stafi, me dalje data dhe lidhje me panelin e akses kontrollit etj.</p>	<p>A (0-20 milionë lekë)</p>

NS-14A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.	<p>F.V kuti suport pllaket 4 mod F.V Çeles 1 polar 220V 10A F.V. Ndricues tip plafoniere, emergjence, 1x18w, IP65 F.V. Ndricues evakuimi me llampe 1x11w, IP40 F.V kuti suport pllaket 4 mod F.V priza shuko universal F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm² F.V tub plastmasi Ø 18-21mm F.V tub plastmasi Ø 22-26mm F.V tub plastmasi Ø 31-36mm F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=2.0m F.V. Percjelles shirit bakri tokezimi ,Cu=30x3mm F.V. Llampe sinjalizimi 220V;1.2w F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm², i zhveshur F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m F.V. Llampe sinjalizimi 220V;1.2w F.V. Automat termo-elektro magnetik, 4P;380V;40A F.V. Llampe sinjalizimi 220V;1.2w F.V tub plastmasi Ø 18-21mm F.V Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=5x6mm² F.V Kanaline metalike e perforuar zingato me vrima S=200x75mm F.V Kthesa kanaline metalike horizontale 90°, Bryl S=200x75 mm F.V Degezim kanaline metalike horizontale 90°, TI S=200x75 mm F.V Shirit led, i vazhdueshëm, 14W/m, 4000K, W1 cm, Ra90 Kuti 3-module, suport, kapak & tapa, instaluar brenda murit F.V Kuti 6-module, suport, kapak & tapa, instaluar brenda murit F.V Kuti instaluese jashtë murit IP55, 105x105x55mm montuar jashte murit dhe ne kanalinen metalike F.V Kuti instaluese jashtë murit, IP55, 175x150x80 montuar jashte murit dhe ne kanalinen metalike F.V Kuti shperndarëse, jashtë murit, IP55, 24x19x9 cm montuar jashte murit dhe ne kanalinen metalike F.V Modul celesi komandimi deviat, 230V, 16A F.V Modul celesi pulsant, 230V, 16A F.V. Sensor levizje PIR IP20, 10s - 7 min, 6m, 1200W, 360° ngjyre te bardhe F.V Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=3x2.5mm² F.V Kapse metalike per kapjen e kabllit direkt ne tavan F.V Kuti Shperndarese jashte murit 150x116mm., Zjarr duruese per 30 minuta E30 Pastel orange, Polypropylene, PP F.V Tub PVC rigid I forte vetshuares, per instalime jashte murit Ø=20mm me kthesa, aksesore, klemeri F.V Kuti 6-module, suport, kapak & tapa, instaluar brenda murit F.V Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=3x1.5mm² F.V Kuti shperndarese plastike me izolim PVC me kapak, PT-5-6, IP55 montuar jashte murit dhe ne kanalinen metalike</p>	A (0-20 milionë lekë)

		<p>F.V Kuti shperndarese plastike PVC me kapak, PT-2-4, IP55 montuar jashte murit</p> <p>F.V Kuti shperndarese plastike PVC me kapak, PT-5-6, IP40 montuar brenda murit</p> <p>F.V Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=3x4mm2</p> <p>F.V. Tub fleksibel i kuq - Ø40mm</p> <p>Tub PVC rigid I forte vetshuares, per instalime jashte murit Ø=25mm me kthesa, aksesore, klemeri</p> <p>F.V.Kabllo bakri TU nje polar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=1x95mm2</p> <p>F.V Kabllo bakri TU nje polar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=1x50mm2</p> <p>F.VKabllo bakri TU nje polar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=1x70mm2</p> <p>F.V Kabllo bakri TU njepolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=(1x35)mm2</p> <p>F.V Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=5x35mm2</p> <p>F.V Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=5x25mm2</p> <p>F.V Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=5x6mm2</p> <p>F.V Kabell bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=5x16mm2</p> <p>F.V Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=5x4mm2</p> <p>F.V Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=5x2.5mm2</p> <p>F.V Kabllo alarmi zjarri JE-H(ST), S=2x1.5mm2 per loop-in e detektoreve</p> <p>V.Central i alarmit te zjarrit, tip inteligjent, i adresueshem, 4 loop-e digital me 127 element per loop, me regjistrim ngjarjesh, modul komunikimi, grafik karte, me porte kompjuterike, i programueshem, me bateri me 72 ore pavaresi</p> <p>V Permutator telefonik me min tre numra</p> <p>V Detektore tymi multi sensitiv, me izolator te inkorporuar, inteligjent te adresueshem, me modul komunikimi</p> <p>V Pulsant manual alarmi zjarri me thyerje xhami, tip 1469,IP-65, me izator te inkorporuar</p> <p>V Sirena alarmi zjarri, me ndricues me llambe vezulluese, per vendosje ne ambient te brendshem, tip inteligjent te adresuesheme, me intesitet 120dB.</p> <p>V Sirena alarmi zjarri, me ndricues me llambe vezulluese, per vendosje ne ambient te jashtem, tip inteligjent te adresuesheme, me intesitet 120dB.</p> <p>F.V Llama sinjalizuese (qe vendosen nen tavanin e gipsit)</p> <p>Patchcorda 0.5-1m FTP CAT.6a</p> <p>Patchcorda 2m FTP CAT.6a</p> <p>F.V Patch Cord FO 3ML</p> <p>F.V Patch guide horizontale</p> <p>F.V Kabllo fiber optike 6 kopje, single mode</p> <p>F.V Priza data RJ45 S/FTP Cat.6A</p> <p>F.V Kabllo rrjeti kompjuterik, tip FTP-Cat.6A, 500 MHz, LSZH Flame retardant</p> <p>F.V Kuti plastike per priza 3-module, suport , kapak & tapa</p> <p>F.V Kanaline plastike, 100x40mm, me aksesore (kthesa, ti etj)</p> <p>F.V Torreto, pllake prizash dysHEMEJE, 20module - 2 priza shuko16A, 230V,2P+T, ngjyre e bardhe (Rrjet) - 2</p>	
--	--	--	--

		<p>priza shuko 16A, 230V / 2P+T, ngjyre e kuqe (UPS) - 1 prize RJ45 RJ45 Cat .6A (internet) - 1 prize RJ45 RJ45 Cat. 6A (telefon) - Kapak me ngjyren e modelit te pllakes se dyshemese - Me 16module, e kompletua F.V Kabllo rrjeti kompjuterik, tip FTP-Cat.6A, 500 MHz, LSZH Flame retardant per linjat e kamerave F.V Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=3x1.5mm2 F.V Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=3x2.5mm2 F.V Kabllo bakri TU nje polar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=1x50mm2 F.V Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=5x6mm2 F.V Dalje Fuqie 400V (Pajisje 3fazore) Dalje Fuqie 230V (Fancoil + Pajisje 1fazore) Kabllo alarmi zjarri FTG10(O)M1, me S=3x1.5mm2, per furnzimin e sirenavete jashtme, me rezistence ndaj zjarrit deri 3ore V.Ndricues tualeti 12W,4500K,840lm,Ø245 V.Ndricues panel,LED 50W, 4000lm, 59.5x59.5 cm, i bardhë, 4000K, IP20, alumin, PMMA, BP21-ose ekuivalent V.Panel LED , SMD, 40W, 6500K, 3200lm, 220V-240V AC ose ekuivalent V.Spot LED GU10 6W, Ø9cm, 4000K, IP20 (ne gips) Kuti shperndarese plastike PVC me kapak, PT-2-4, IP55 montuar jashte murit Kuti shperndarese plastike me izolim PVC me kapak, PT- 5-6, IP55 montuar jashte murit dhe ne kanalinen metalike V.RACK Kompjuterik 19"42U, i kompletuar me te gjithë aksesoret, tip metalik, me dere xhami te armuar, me celes, drejtues te kablllove, me bllok te inkorporuar moduli ushqimi dhe ventilimim, me 2 grupe me nga 8 priza shuko 230V, 16A me tokezim V. Patch Panel me 24 porta - RJ45 FTP cat 6a V.Switch i menaxhueshem POE me 24 Porta RJ45 24 RJ-45 Port Gigabit Smart Switch me 24 porta RJ-45 (10/100/1000) Mb/s, 4 x SFP 1000 Mb/s, 4 x 1000BASE- X SFP, 104 Gb/s Routing/Switching Capacity, 128 MB SDRAM (Interneti) Kabllo rrjeti kompjuterik, tip FTP-Cat.6A, 500 MHz, LSZH Flame retardant Kabllo fiber optike 6 kopje, single mode Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=3x2.5mm2 Kabllo bakri TU multipolar, Un=0,6/1 KV; tip FG16OR16; S=3x1.5mm2 Tub PVC rigid I forte vetshuares, per instalime jashte murit Ø=20mm me kthesa, aksesore, klemeri kamerat Kuti shperndarese plastike me izolim PVC me kapak, PT- 2-4, IP55 montuar jashte murit dhe ne kanalinen metalike Prize rrjeti Data RJ45 Cat.6A, montuar ne kuti 2 mod jashte muri Patch corda 0.5-1m FTP CAT.6a Shirit zingato Fe/Zn 30x3.5mm Morseta bashkuese T-I & kryq universale tokezimi 30x3.5mm Shine shperndarese tokezimi, per matje komplet & kuti PT-5; Ip-65, me shenje "toke" Shperndarese ekuipotenciale tokezimi, pllake bakri me 12 terminale, dimension 495x95x85mm</p>	
--	--	--	--

		Shtize rrufepritse, tub zingato Ø=16mm, L=50cm, per mbrojtjen nga goditjet atmosferike Kubike betoni me izolim PVC Pusete tokezimi PVC 30x30x30cm Kabinet multifunksional modular G 36modular, i kompletuar me kapak me dere xhami, me shina, dhe te gjithë aksesoret W600, H1980, D205 Aparat mates multifunksional EMDX 3 modular, RS485 me mundesi komunikimi te dhenash Shkarkues toke SPD T1+T2 40kA 4P F V Automat magneto-termik 3P+N, 200A, 36kA F V Automat magneto-termik 3P+N, 250A, 36kA Automat magneto-termik 3P+N, 125A, 36kA etj.	
--	--	---	--

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me licensë leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”*. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”*.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: *“Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”*.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi, si “Transport dheu dhe mbeturinash me auto deri në 7 km”, etj.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës

që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per **3 (tre) muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik

- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.*

*Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.*

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik te punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.

2.3.6 Një punësim minimalisht prej **40** (dyzet) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3 muajt** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per **3 muajt** e fundit te deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen për të përmbushur kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit te tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përipiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun

e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendorsja e kriterit për një punësim të paktën 65 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë puntorë që kërkohet për realizimin e punimeve është min **40 punonjës**

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

Teknik Ndertimi	1
Punonjes per dyer , dritare	2
Hidroizolues	2
Suvatues	3
Pllakashtrues	2
Bojaxhi	2
Elektracist	2
Hidraulik	2
Instalues dhe riparues te sistemeve ngrohje-ftohje	2
Shofere/Manovratore	1

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.7/1 Për punonjësit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR. *(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë punë (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga organe kompetente. Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve për punimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriteret e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është percaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore. Personeli i mësipërm kërkohej në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.*

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:
1 (një) punonjes i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Shënim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* si dhe për *Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit e kerkuar, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet te jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" rekomandohet te jete ne kantier per minizimin e aksidenteve ne pune.

2.3.11. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve **SSH EN ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **SSH EN ISO 14001-2015** (e vlefshme) /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën **SSH ISO 45001:2018** ose **SSH EN ISO 45001-2023** (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë) ose ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Çertifikatën e menaxhimit te energjise **SSH EN ISO 50001-2018**/ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.12 gërma “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

SSH EN ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

SSH EN ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë

mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

SSH ISO 45001-2018 ose **SSH EN ISO 45001-2023** është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

SSH EN ISO 50001-2018 është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 50001-2018.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike të parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.12, gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.13. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetshkarkues me kapacitet min 1.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Minieskavator	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Vinc	copë	1	Në pronësi ose me qera

5	Autovinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Gjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Depozite uji deri ne 5000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Pompe Suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Vibrator	copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Paisje niveluese për nivelim shtresash	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Pompë uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Skela	m2	500 m2 (min)	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); c) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike,

për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projektet e zbatimit, bashkëlidhur DST-ve, të dërguara pranë organit qendror blerës nga Autoriteti Kontraktor përfitues (Qendra e rekrutim personelit).